



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:227642

Datë: 14.11.2024

Numri i dokumentit: 06450426

C-IV-13-2607

Parashtruesja e kërkesës

B T nga Prizreni
kundër

Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit – AKP (N.SH. “IFS Progres” në Likuidim), Rr. ‘Dritan Hoxha’ nr.55, Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 14 nëntor 2024, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- I. Ankesa e ankueses refuzohet si e pabazuar.**
- II. Vërtetohet Vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRZ034-0205 datë 14 tetor 2013.**
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 25 tetor 2013, ankuesja parashtrorj kërkesë për rishqyrtimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (në tekstin e mëposhtëm AL) PRZ034-0205 datë 14 tetor 2013 (në tekstin e mëposhtëm Vendimi), me të cilin kërkesa mbi kompensimin e tre (3) pagave të papaguara në shumë prej 900.00 (nëntë zero zero) Euro, ndaj NSH “IFS Progres” (në likuidim), është refuzuar.

Ankuesja konsideron të drejtën në kompensim e cila është rregulluar dhe parashihet nga e drejta në ligje dhe kontratë kolektive dhe duke u bazuar në dokumentacionin të cilat janë në disponim të palës kundërshtare, AKP.

Ankuesja konsideron se arsyetimi i Vendimit të AL është në kundërshtim me vetveten sepse, sipas ankueses në njërin pjesë të saj thuhet si e afatshme gjersa në pjesën tjetër si e paafatshme.

Ankuesja përfundimisht kundërshtoj Vendimin e AL lidhur me parashkrimin e kërkesës së saj mbi pagat.

Nga gjitha arsyet i propozoj gjykatës që Vendimi i AL të priset dhe kërkesa e saj të aprovohet.

Kërkesës për rishikim i është bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, datë 2 prill 2014, ankuesja me 28 prill 2014 parashtroj një kërkesë për ndihmë në përkthim.

Duke vepruar sipas urdhrin të gjykatës, AKP me 11 korrik 2014 parashtroj përgjigjen.

AKP kundërshtoj pretendimet e ankuesit si të pabazuara. AKP pohon se AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar në mënyrë të drejtë. AKP tutje pohon se ankuesja nuk ishte e punësuar pranë NSH me rastin e privatizimit të saj, andaj sipas AKP ankuesja nuk ka plotësuar kushtet ligjore ashtu siç parashihet sipas nenin 40.1.6.1 të Shtojcës së Ligjit për AKP. AKP tutje pohon se kërkesa kreditore e ankueses konsiderohet e parashkruar në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit mbi punën e bashkuar – LPB lidhur me dispozitat e Shtojcës së Ligjit për AKP. Nga të gjitha arsyet propozoj që kërkesa për rishikim të refuzohet si e pabazuar dhe që Vendimi i AL të vërtetohet.

Përgjigjes i është bashkangjitur:

- Listën e pagave të punëtorëve, të NSH, për muajin tetor 2006 e gjer muajin prill 2007.

Sipas kësaj liste, të bashkangjitur, gjykata gjeti se ankuesja nuk ishte e përfshirë në listën e pagave të NSH (në tekstin në vijim LISTA E PAGAVE).

Bazuar në urdhrin e gjykatës, ankuesja me 6 gusht 2014 parashtroj përgjigjen ndaj përgjigjes së AKP.

Ankuesja kundërshtoj pohimet e AKP të dhëna në përgjigje. Ankuesja konsideron se AL i ka cenuar të drejtën e saj që rrjedhin nga marrëdhënia e punës pasi që ka ushtruar kërkesën e saj në afatin e paraparë si dhe ka inicuar procedurë pranë gjykatës. Ankuesja gjithashtu pohon se ishte e përfshirë në listën e punëtorëve me të drejtë në pjesën e 20% nga privatizimi i NSH. Lidhur me parashkrimin e kërkesë, mbi pagat, ankuesja thekson se Ligji për punën e bashkuar të cilës i referohet AL është ligj i shfuqizuar me Ligjin mbi ndërmarrjet (gazeta zyrtare e RSFJ nr. 77/88) andaj si i tillë është i paaplikueshëm. Nga të gjitha arsyet i propozoj gjykatës që përgjigja e AKP të konsiderohet si e pabazuar.

AKP, sipas urdhrin të gjykatës, me 2 tetor 2014 parashtroj kundërpërgjigjen.

AKP mbeti në tërësi si pranë përgjigjes së saj me propozim që kërkesa për rishikim të refuzohet si e pabazuar dhe që Vendimi i AL të vërtetohet.

Arsyetimi Ligjor

Kërkesa për rishikim-ankesa konsiderohet e pabazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit për DHPGJS (ligji nr.06/L-086) në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Në rastin konkret bazuar sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS është obligim i palës, në këtë rast ankueses, që në parashtresat e saj me shkrim, ankesën, të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsyetimit ligjor mbi të cilin vendos

qëndrimin dhe argumentimin e saj. Në rastin kur pala pohon, në këtë rast ankuesja, të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi.

Nga dispozita e cekur si më lartë, është obligim i ankuesit që të dëshmoj detyrimet ndaj saj, mbi mos pagesën e të ardhurave personale.

Lidhur me pagat e papaguara, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 parashihet përmbushja e kërkesave për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në.

Nga dispozitat e lartcekura, mund të konkludohet se, punëtori gëzon të drejtën në paga nëse:

- a. pagat e punonjësit, në këtë rast ankueses, nuk i janë paguar;
- b. pushimi nga puna ka ardhur si pasojë i Vendimit të AL, dhe
- c. ndonjë veprim nga Agjencia, lidhur me administrimin e ndërmarrjes, shitjes, likuidimit etj.

Tutje sipas nenit 40 paragrafi 1.7 parashihet përmbushja e kërkesave përfshirë kërkesat e pasiguruar, përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë.

LISTA E PAGAVE, parashtruar nga ana e AKP, e përpiluar dhe lëshuar nga organi menaxhues i NSH, tregon se ankuesja nuk ishte e përfshirë në listën pagave të punëtorëve të NSH.

Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankueses lidhur me të drejtën e saj në kompensim për paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Andaj ankuesja nuk ka dëshmuar të drejtën e saj mbi pagat ashtu siç edhe parashihet sipas nenit 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP, paragrafi 1.6 pika 1.6. si dhe paragrafit 1.7, por edhe nuk ka dëshmuar ndonjë obligim tjetër ashtu siç parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS.

Nga gjitha arsyet u vendos si në dispozitiv.

Taksa Gjyqësore:

Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, nuk caktohen taksa gjyqësore në këtë procedurë ankimore, pasi që vlera e kontestit është 1,000 Euro.

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar